

# NACIONALIZMI DHE USHTRIA NË REGJIMIN KOMUNIST

## (Rast studimor Forcat e Armatosura të RP së Shqipërisë)

Etleva SMAÇI<sup>1</sup>

<sup>1</sup>Akademia e Forcave të Armatosura

<sup>2</sup>Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë

\*[etleva.smaci@aaf.mi.al](mailto:etleva.smaci@aaf.mi.al), [evasmaci@gmail.com](mailto:evasmaci@gmail.com)

---

### Abstrakt

Shtjellimi i koncepteve nacionalizëm dhe patriotizëm do të jenë dy elementet kryesore të këtij punimi. Ndërsa studiuesit e kanë të qartë dallimin mes dy koncepteve për masën e gjerë të popullatës loja me ndjenjat patriotike ka çuar në jo pak shembuj historik në lindjen dhe fuqizimin e sistemeve politike ekstremiste nacionaliste. Por synimi i punimit nuk është analiza e masave në gjerësi, por e një segmenti të veçantë të shoqërisë, ushtrisë shqiptare gjatë regjimit komunist. Argumenti që do të shtjellohet është: si formësohet ushtria e një regjimi komunist në emër të nacionalizmit? A shfrytëzohen ndjenjat patriotike të Forcave të Armatosura për të tejzgjatur jetën e një regjimi totalitar? Nisur nga fakti se një ndër tiparet bazë të karakterit që ushtaraku formëson që në fillimet e edukimit të tij është besnikëria, punimi do të provojë të argumentojë se ky tipar bëhet mjete më i rëndësishëm ideologjik për të përcjellë mesazhe nacionaliste që deformojnë të vërtetën historike në regjimet totalitare.

Ushtria shqiptare e periudhës së komunizmit që në këtë kumtesë sillet si rast studimor ka si veçori dalluese se ndjenjën e besnikërisë ndaj vendit e identifikoi me ndjenjën e besnikërisë ndaj një grupi të caktuar hegjemonist në pushtet Partisë së Punës. Pra, nëse në shumë punime është shpjeguar qartë lidhja e natyrshme e nacionalizmit me luftën, qasja në rastin tonë do të ketë në qendër si u interpretua nacionalizmi nga forcat e armatosura gjatë regjimit komunist dhe si ndikoi përvoja e tyre personale mbi “armikun imagjinar” në këtë interpretim. E thënë në mënyrë të përmbledhur përfundimet që punimi synon të arrijë lidhen me pyetjen se si u interpretuan nga forcat e armatosura gjatë regjimit komunist mesazhet e patriotizmit, sakrificës, unitetit kombëtar në emër të ideologjisë komuniste, veshur me petkun e nacionalizmit.

**Fjalë kyçe:** *nacionalizëm, patriotizëm, forca të armatosura, komunizëm, ideologji.*

---

### Hyrje

Në literaturën botërore në lidhje me nacionalizmin ka një numër të madh studimesh empirike që tentojnë të shpjegojnë lidhjet mes nacionalizmit dhe luftës. Por nga ana tjetër ka një numër të kufizuar studimesh të kësaj natyre të cilat dokumentojnë specifikisht për vendet komuniste sesi gjatë procesit të shtetformimit qeveritë monopartiake përdorin struktura të caktuara si forcat e armatosura për të ndikuar në ndjenjat nacionaliste të kombit. Vetë koncepti i nacionalizmit është i lidhur me besnikërinë ndaj shtetit dhe ndjenjat e patriotizmit, dy tipare kyçe për forcat e armatosura në ndërtimin e identitetit të tyre. Në analizën në vazhdimësi të këtij punimi fokusi do të jetë tek përdorimi i forcave të armatosura si një element i rëndësishëm për të rritur ndjenjën e nacionalizmit difensiv gjatë periudhës së shtetformimit komunist.

Punimi ka strukturën si më poshtë. Së pari, do të japim një rishikim të literaturës që trajton lidhjet mes nacionalizmit, komunizmit dhe militarizmit. Më pas punimi do të ndalet në analizën e trashëgimisë nacionaliste si dhe tek krahasimi i dy tipareve të rëndësishme të përmendura më lart: patriotizmi dhe uniteti kombëtar duke sjellë ilustrime dhe të dhëna nga ushtria shqiptare e periudhës së komunizmit. Dhe së fundmi, disa përfundime që burojnë nga analiza.

Metodologjia e përdorur në këtë punim është ajo e një rasti studimor, një strategji kërkimore që synon të kuptojë dukurinë në lidhje me një grup të vetëm, në rastin tonë Forcat e Armatosura të Shqipërisë gjatë regjimit komunist. Në këndvështrimin e autores, ky rast studimor përshkruhet dhe është i përshtatur në varësi të periudhës historike të zgjedhur.

### ***Nacionalizmi, komunizmi dhe militarizmi***

Duke analizuar lidhjet mes nacionalizmit dhe komunizmit Martin Mevius[1] argumenton se ka dy mite në lidhje me këtë raport. I pari lidhet me hamendësimin se nacionalizmi me komunizmin janë kundërshtarë dhe i dyti, me tezën se nacionalizmi ishte shtypur në vëndet e Europës Lindore përpara vitit 1989. Një tjetër studiues i shkencave politike, Barry Posen është ndalur gjatë në lidhjet e nacionalizmit me luftën, ku forcat e armatosura janë të ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo. Sipas studiuesit Posen politikat nacionaliste i japin mundësi regjimeve të mobilizojnë jo vetëm forcën e armatosur por edhe masat, duke krijuar shpirtin e sakrificës ndaj atdheut.[2] Ajo që ky studiues veçon është indoktrinimi dhe rrënjësia e patriotizmit për të motivuar forcat e armatosura në planin ushtarak. Në lidhje me argumentin e Mevius, në fakt në vëndet komuniste të Europës Lindore, bashkimi i lindur mes komunizmit dhe nacionalizmit nuk rezulton të jetë i lidhur drejtpërdrejt me tiparet e drejtuesve të regjimeve komuniste sesa me kushtet politike dhe shoqërore ku ata u gjendën.[3]

Për sa i përket hamendësimit të parë, le të shohim faktin se si Partia Komuniste e më pas Partia e Punës e prezantonte veten në radhët e ushtrisë si një mbrojtëse e interesit kombëtar. Ky portretizim vetjak nacionalisto -komunist nuk ishte një tipar përjashtues, por një tipar që do t'i jepte të drejtën për të udhëhequr vëndin në emër të interesave kombëtare, që forcat e tjera politike ishin anatemuar se i kishin vënë në rrezik. Për të fshehur faktin se komunizmi e përdorte nacionalizmin si të gjitha ekstremet e tjera ideologjike u fabrikua “socializmi patriotik,”[1] një formë besnikërie ndaj shtetit të diktaturës së proletariatit. Po kështu për të krijuar shtratin e nevojshëm për mitin e parë u huazuan shprehjet “nacionalizëm borgjez”, “shovinizëm” etj.

Hamendësimi i dytë për një nacionalizëm të shtypur lidhet me faktin se koncepti nationalist ishte “dënuar me vdekje” në Shqipëri që në përfundim të Luftës së Dytë Botërore. Të ishte nationalist për Partinë Komuniste Shqiptare e më vonë PPSH ishte armik. Por gjatë qeverisjes totalitare të shtetit shqiptar vërehet e njëjta dukuri si në shumë vende të tjera të Lindjes. Ashtu si edhe kanë arritur në përfundime disa studiues si David Kaiser,[4] Heribert Adam,[5] Martin Mevius,[1] pavarësisht retorikës antinacionaliste të ideologjisë komuniste, këto regjime arritën të qëndronin gjatë në pushtet dhe të legjitimoheshin përmes thirrjeve nacionaliste, edhe pse deviza e tyre shpallur ishte internacionalizmi.

Në rastin e Shqipërisë, në fusha të caktuara ku bënte pjesë edhe ushtria internacionalizimi ose “vëllazërimi nën armë” dështoi të ishte i sukseshëm. Kujtojmë këtu se pas prishjeve të njëpasnjëshme me jugosllavët, sovjetikët dhe në fund me kinezët në të gjitha rastet këto vende u akuzua se internacionalizmi i tyre proletar bazohej në interesin e tyre kombëtar dhe ky nuk ishte një konkluzion i gabuar. Në fushën e mbrojtjes u kalua në motot “I gjithë populli ushtar” apo “Shqipëria fortesë graniti në brigjet e Adriatikut.”

Mund të konsiderohet pikërisht ky momenti kur Enver Hoxha eksperimentoi në radhët e ushtrisë teoritë marksiste mbi nacionalizmin sipas modelit vetjak ose siç thotë Walker Connor ndërtoi një strategji si të manipulonte teoritë e nacionalizmit për t'i shërbyer ideve të tij marksiste.[6]

### ***Trashëgimia nacionaliste në forcat e armatosura***

Forcat e Armatosura të pas Luftës së Dytë Botërore trashëguan një retorikë nacionaliste të dukshme që theksin e vinte tek aspekti i vetëmbrojtjes. Përdorimi i ndjenjave kombëtare, evokimi i periudhave të caktuara të historisë siç ishte periudha e Skënderbeut, krijimi i një narrative që vinte theksin në të drejtën për vetëvendosje ishin përbërësit kryesorë mbi të cilët do të mbështetej qasja ndaj pushtetit e regjimit komunist të udhëhequr nga Enver Hoxha. Ky i fundit e kapitalizoi shumë fitoren në Luftën e Dytë Botërore, nga formacionet ushtarake të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Në tekstin e “Historisë së Artit Ushtarak Botëror”, krahas tezës se populli shqiptar kishte zhvilluar gjithmonë luftëra të drejta (sipas këtij teksti mësimor vetëm shtetet socialiste mund të zhvillonin lufta të drejta) për mbrojtjen e atdheut, i jepet përparësi faktit se Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e udhëhequr nga Partia Komuniste Shqiptare me në krye Enver Hoxhën ishte shembulli më i shkëlqyer i organizimit ushtarak, jo vetëm sepse e çliroi vendin nga pushtuesit, por edhe nga shypja e klasave reaksionare.[7]

Kjo luftë do të shërbente si një pikë kthese në nacionalizmin shqiptar, pasi ishte lufta e parë e zhvilluar në emër të Shqipërisë krahas aleatëve dhe e para në të cilën nacionalizmi u përdor si instrument për një mobilizim masiv dhe/ose një ndjenjë solidariteti mes bashkatdhetarëve.[8]

Regjimi komunist nuk e pati të vështirë të vazhdonte të mbante të gjallë idenë e dalë nga një vrundull nationalist se populli shqiptar ishte në një luftë të përhershme kundër një hordhie armiqsh. Madje i mbiveshi një tjetër mit nationalist duke e deformuar historinë e jetës së shkurtër të shtetit shqiptar. Nëse i referohemi tekstit mësimor të shkollës ushtarake “Skënderbej”, “Historia e Artit Ushtarak Botëror”, populli shqiptar kishte krijuar forcat e tija të armatosura për të përballuar sulmet e armiqve të shumtë qysh nga koha e legjioneve romake e deri tek pushtuesit italianë e gjermanë.[7] Këto forca sipas këtij teksti mësimor ishin shquar për heroizmin masiv dhe karakterin popullor[7] Në ndërtimin e retorikës nacionaliste brenda këtij teksti përdoren klishetë e krijuara nga udhëheqësi komunist Enver Hoxha në lidhje me disa tipare karakteristike të Ushtrisë Popullore.

- a) Ajo e kishte origjinën e saj në popull. Fshatarët dhe punëtorët e kishin krijuar atë.
- b) Ushtrinë Popullore e karakterizon qëllimi i saj, për të cilin ishte krijuar nga Partia dhe populli dhe brenda këtij qëllimi ekzistonte njëkohësisht dhe e pandarë lufta kundër pushtuesve fashistë dhe nazistëve gjermanë.
- c) Forca e ushtrisë, që ishte formuar nga populli qëndronte tek populli (punëtorët dhe fshatarët) dhe jashtë këtij kuptimi nuk mund të kishte një ushtri të pathyeshme siç propagandohej të ishte ushtria shqiptare.
- d) Një ushtri e tillë ishte njëkohësisht edhe një ushtri internacionaliste, e cila nuk mund t'i hidhte armët për asnjë çast, derisa të shkatërrohej përgjithmonë kapitalizmi...[7].

Të gjitha karakteristikat e përmendura më lart ofrojnë një pretekst bindës për një sërë lëvizjesh me karakter nacionalisto -komunist brenda forcave të armatosura. Një luftë e pandërprerë kundër “agjentëve të ndryshëm të imperializmit” që kërcënonin vetë ekzistencën e Republikës Popullore të Shqipërisë u bë një pikë qendrore e edukimit të tyre ushtarak dhe qytetar.

Koncepti sundues në doktrinën ushtarake shqiptare të periudhës së komunizmit do të bëhej “i gjithë popullit ushtar” i modeluar sipas parimit “atdheu është i gjithë popullit prandaj ai duhet të mbrohet nga i gjithë populli”[9].

Studiuesi Bernd Fischer në librin e tij *Nacionalizmi shqiptar* pohon se pavarësisht orientimit ortodoks stalinist të Enver Hoxhës pas Luftës së Dytë Botërore, nacionalizmi vazhdoi të ngelej në thelb të politikës së tij.[10] Të njëjtën ide e gjejmë edhe në librin e fundit të Fischer dhe Schmitt *Një histori e përmbledhur e Shqipërisë*. Autorët arrijnë në përfundimin se një ndër dy elementet kritik të përbërjes ideologjike të Hoxhës në politikën e tij ishte nacionalizmi, i cili do të bëhej më i dukshëm pas prishjes me Bashkimin Sovjetik dhe ftohjen me Europën Lindore.[11] Tiparet e nacionalizmit të shfaqura gjatë regjimit komunist ishin të njëjta me ato të regjimit: etatizmi, kolektivizmi, autarkia.[3] Besimi dogmatik komunist tek shteti monist ishte shtrati i ndërtimit të një nacionalizmi të miksuar, një nacionalizmi që në terma ushtarak në këtë punim do ta quajmë “nacionalizëm difensiv”.

Në të gjitha fjalimet, veprat apo dhe dokumentet zyrtare deri më tani nuk rezulton që fryma nacionaliste e përhapur gjatë rregjimit komunist të ketë pasur karakter ofensiv hegjemonist. Sulmet nacionaliste veçanërisht të Enver Hoxhës lidheshin me taktikat e tij mbrojtëse dhe përdorshin për qëllime të brendshme. Ushtria ishte arma ku parimet e saja taktike mund të gjenin shprehjen më të mirë. Studiuesi Misha Glenny në librin e tij të ripunuar *Historia e Ballkanit 1804- 2012* flet gjithashtu për “nacionalizmin mbrojtës” duke ju referuar retorikës së egër të fjalimeve të Enver Hoxhës kundër atyre që ai i shpallte kundërshtarë.[12]

### ***Patriotizmi, shkopi magjik i nacionalizmit***

Për të bërë dallimin mes nacionalizmit dhe patriotizmit kërkohet që të bëjmë një përkufizim të tyre paraprakisht. Kjo pasi ndërsa studiuesit i kanë të qartë kufinj të ndarës për një pjesë dërrmuese të popullatës shpesh konceptet konsiderohen si sinonime. Diskutimet për patriotizmin dhe nacionalizmin shpesh dëmtohen nga mungesa e qartësisë së përkufizimit. Është interesante qasja e bërë në “Enciklopedinë e Filozofisë së Strandford” nga një grup autorësh. Ata i referohen tri këndvështrimeve.

I pari vjen nga shekulli i 19-të, Lord Acton i cili vë në kontrast nacionalizmin dhe patriotizmin si dashuri dhe instikt kundërt një marrëdhënieje morale. Për të nacionalizmi është lidhja jonë e natyrshme ose fizike me racën, kurse patriotizmi shihet prej tij si ndërgjegjësim i detyrave tona morale ndaj komunitetit politik.[13] Si përfaqësues i fillimit të shekullit të 20-të është zgjedhur Elie Kedourie i cili pohon të kundërtën, duke e paraqitur nacionalizmin si një doktrinë të plotë filozofike dhe politike për kombet si njësi bazë të njerëzimit brenda të cilave individit mund të gjejë lirinë dhe përmbushjen dhe patriotizmin si një ndjenjë të thjeshtë dashurie për vendin.[13]

Një këndvështrim i tretë i përket George Orwell i cili i kategorizon konceptet e mësipërme në sjellje agresive dhe difensive. Nacionalizmi sipas Orwell ka të bëjë me pushtetin. Adhuresi i tij dëshiron të fitojë sa më shumë pushtet dhe prestigj për kombin e tij, në të cilin ai zhyt individualitetin e tij. Ndërsa nacionalizmi është agresiv në përputhje me rrethanat, patriotizmi është mbrojtës e përmyll ai dallimin mes dy kategorive.[14] Ne do t'i referohemi në këtë trajtesë këndvështrimit të Orwell pasi në ligjërimin e përdorur nga udhëheqja komuniste gjejmë pikërisht përdorimin e retorikës nacionaliste në funksion të pushtetit dhe patriotizmit për të krijuar standardin e dyfishtë të formës “ne kundër tyre”. Që në ditën e parë të marrjes së pushtetit nga komunistët në Shqipëri me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, filli që do të përshkonte të gjitha doktrinën ushtarake ishte ruajtja e sovranitetit.

Kërcënimet reale dhe imagjinare ndaj shtetit të pavarur shqiptar do t'i shërbenin regjimit që gjatë procesit të ndërtimit të shtetit komunist retorikën nacionaliste kundër armiqve ta zbulonte me magjinë e patriotizmit, një ndjenjë solide tek shqiptarët dhe një tipar karakteri tek ushtarakët. Nacionalizmi do të përdorte si një instrument të rëndësishëm ndjenjat patriotike për të siguruar mobilizimin e ushtrisë në emër të Partisë shtet. Partia ishte organizatorja, frymëzuesja dhe udhëheqësja e luftës popullore dhe ajo ishte njëkohësisht edhe siguria më e madhe për të arritur fitoren mbi armikun.[7]

“Ushtria jonë duhet të ketë koncepte të drejta për rëndësinë politike që merr ajo në situatën e vështirë, që do të krijohet për atdheun tonë, kur të gjendet përballë sulmeve të armiqve agresorë dhe pushtues. Duhet gjithashtu të ketë të qartë se atdheu duhet mbrojtur pëllëmbë për pëllëmbë me sakrificë dhe me gjak.”[15]

Efektiviteti i ushtrisë u ndikua nga sentimente patriotik i orientuar të shndërrohej në një qasje nacionaliste komuniste. Tek modeli i patriotizmit të indoktrinuar te forcat e armatosura gjejmë pothuajse ato përbërës që Nathanson shpjegon në punimin e tij.[16] Atdhedashuria e evokuar veçanërisht nga Lufta Antifashiste krijoi në radhët e ushtrisë ushtarakun e gatshëm të vdiste në luftë me armikun (të sakrifikohej në emër të atdheut/ partisë), të ishte i shqetësuar për mirëqënien e atdheut/socializmit, të identifikonte veten me Shqipërinë/Pushtetin Popullor, të identifikohet me dashurinë për vendin/ regjimin. Këto ishin tiparet patriotike që do të mbruheshin tek njerëzit në uniformë me marrjen e pushtetit nga regjimi komunist. Ata duhet të motivoheshin por tashmë mbi një identitet të ri nacional që kishte filluar ta përpunonte udhëheqja e re e vendit. Këtij modeli studiuesi Robert Elsie i referohet si “një popull i vogël revolucionar që ishte në luftë kundër një numër armiqsh dhe pushtuesish”. [17]

Që prej fillësës së krijimit të shkollave ushtarake, oficerët e rinj trajtoheshin si “bijtë e Shqipërisë” dhe “fidanishtja e Partisë”. Shkollat, trajnimet ushtarake dhe gazetatat përhapnin idenë se ushtarakët kishin një identitet dhe fat të përbashkët që mund të mbrohej vetëm nga shteti. Një version sa nacionalist aq edhe i militarizuar i historisë së këtij grupimi shoqëror.

“Shkollave ushtarake duhet t'u vëmë, gjithashtu, rëndësi të madhe. Atje të dërgojmë kurdoherë kuadro të rinj të devotshëm, bij të punëtorëve dhe të fshatarëve, bij të patriotëve dhe të komunistëve, të cilët t'i edukojmë që të gjithë me një disiplinë të fortë proletare ushtarake dhe t'i pajisim me ndjenjën e sakrificës, të heroizmit dhe të qëndrueshmërisë. Studentët tanë, që dalin oficerë, t'i edukojmë të mos njohin as frikën, as panikun, të mendojnë me kokë në bazë të teorisë sonë marksiste-leniniste.”[15]

Cilat ishin pasojat e nacionalizmit komunist në radhët e ushtrisë? Së pari, patriotizmi i rrënjësor përmes miteve dhe tjetërsimit të historisë krijoi modelin e patriotizmit të verbër. Patriotizmi i verbër i forcave të armatosura u karakterizua nga pranimi i vendimeve dhe veprimeve politike të udhëheqjes komuniste shqiptare. Ky patriotizëm u shoqërua me një ndjenjë besnikërie të padiskutueshme. Patriotizmi i verbër i forcave të armatosura nëse i referohemi autorëve Schatz, Staub dhe Lavine kishte si objekt dhe ishte plotësisht i varur nga ideologjia (objekt mund të ishin edhe populli, shteti, opinioni, koncepti).[18] Si moment kritik të kësaj varësie ideologjike mund të ilustrujmë sjelljet e ushtarakëve shqiptarë në bazën e Vlorës, të cilit në emër të patriotizmit të verbër inskenuan skena nacionaliste me ushtarakët sovjetikë që mund të kishin shërbyer si shkëndijë e një konflikti ushtarak në kulmin e Luftës së Ftohtë.[19]

Në literaturën botërore që trajton çështjet e nacionalizmit, ky i fundit shihet si një ndër faktorët luftënxitës. Dhe shtetet të cilat i vënë tezat nacionaliste në themel të shtetformimit të tyre prirën të rrisin aftësitë luftarake. Mjafton të sjellim si shembull se Hitleri me ardhjen në fuqi si kancelar në vitin 1933 një ndër masat e para që mori ishte kthimi i kapaciteteve ushtarake të cilat i ishin mohuar dhe ndaluar Gjermanisë nga Traktati i Versajës.

Militarizimi i ushtrisë shqiptare ose “armatosja deri në dhëmbë” u justifikua me rrezikun e përmbysjes së pushtetit popullor. Pas prishjes me Bashkimin Sovjetik në vitin 1961, që shënon dhe largimin *de facto* nga Traktati i Varshavës, tendencat nacionaliste të shfaqura përmes mbrojtjes së sovranitetit u shoqëruan me një fuqizim ushtarak të ushtrisë shqiptare përmes ndihmave të ardhura nga Kina.

Ishte pikërisht retorika nacionaliste e rrezikut të një sulmi të organizuar amerikan - sovjetik në bashkëpunim me jugosllavët që çoi pas pushtimit të Çekosllavakisë nga BS në bunkerizimin e vendit. Gjatë mbledhjes së Sekretariatit të KQ PPSH më 29 maj 1976 do t’i mëshonte idenë se “këto ndërtime bëhen për mbrojtjen e interesave të atdheut në rast lufte.”[20] Kurse sasia e madhe e armatimit ishte e kuptueshme në kuadër të politikës “i gjithë populli” ushtarak. Koncepti “gjithë populli ushtarak” është një variant komunist i Luftës Totale, doktrinës nacionaliste të hartuar nga Ludendorfi, shefi i Shtabit të ushtrisë gjermane dhe të propaganduar me të madhe nga Gëbelsi, në fjalimin e mbajtur më 18 shkurt 1943, në Sportpalast. Elemente të ngjashme me fjalimin e lartpërmendur gjejmë në jo pak fjalime të Enver Hoxhës ku fokusi është ushtria. Madje dhe intonacioni dhe gjestikulacionet kanë ngjashmëri.

Për të ilustruar idenë e mësipërme le të shohim fjalimin e mbajtur më 1 shtator 1978 me sekretarët e Komitetit Qendror. Fjala titullohet “Jemi të përgatitur për kohë lufte, kur shtërvitemi e punojmë mirë në kohë paqeje”. Fjalimi është tipik i një lideri nacionalist që përgatit kombin e vetë për luftë. Problemet që diskutohen janë që nga strehimi në kohë i popullatës, zinxhiri i komandimit në ushtri, prodhimi në kohë lufte dhe deri tek përgjegjësitë e udhëheqjes.[21] Pamundësia reale që kishte Shqipëria për të siguruar një sistem sigurie të qëndrueshëm edhe përmes militarizimit tej kapaciteteve ekonomike, sidomos në periudhën e izolimit 1970-90, e bëri nacionalizmin komunist tepër agresiv. Në Shqipëri, në këtë periudhë shpenzimet për mbrojtjen arritën 11.5 %. Kjo ndodhte në një kohë kur Lufta e Ftohtë ishte në kurbën e saj ulëse, ishte koha e detantës së dytë. Si kurrë më parë në Shqipëri u shënuan 2200 pika përhapje në gjithë vendin, numri i trupave aktive arriti në 65 mijë efektivë (këtu përfshihej ushtria, forcat e kufirit, forcat e ministrisë së brendshme) si dhe 100.000 civilë rezervistë aktivë.

### ***Miti i unitetit kombëtar dhe besnikëria***

Ushtria ka aftësinë që të ndërtojë mes anëtarëve të saj një sens të identitetit kombëtar që në fakt e ka burimin tek uniteti i kësaj organizate. Që në ditën e parë ushtaraku bëhet i ndërjegjshëm se i përket një grupi që ka një mision të unifikuar. Është me interes të analizojmë trekëndëshin popull, parti, ushtri. Ushtria e regjimit komunist njihej me emrin Ushtria Popullore. Në nenin 88 të Kushtetutës së vitit 1976 shprehet qartë se “ Ushtria Popullore, si forca kryesore për mbrojtjen e atdheut, është ushtri e popullit dhe i shërben popullit. Forcat e armatosura udhëhiqen nga Partia e Punës”. [22]

Indoktrinimi i hershëm i lejoi Hoxhës të përjetësonte mesazhin e tij për unitetin kombëtar, idealet partiake dhe hipernacionalizmin si bazë të identitetit shqiptar më shumë se kudo në radhët e forcave të armatosura. Të gjitha fjalimet që i drejttoheshin ushtrisë popullore kishin sllogane të qarta që mbështesnin frymën agresive ndaj “armiqve të Shqipërisë” imperialistë, revizionistë dhe fqinjët shovinistë. Mospranimi i kësaj teze ishte minim i të ashtuquajturit “unitet kombëtar”. Ajo çfarë e dallonte këtë nacionalizëm që më lart e kemi quajtur difensiv ishte fakti se ushtria nuk u mobilizua kurrë për sulm, por ishte gjithmonë në favor të doktrinës ushtarake mbrojtëse, por që në thelb synonte kontrollin e brendshëm, veçanërisht ushtrisë si e vetmja fuqi që ishte e aftë të realizonte një përmbysje sistemi përmes metodave ushtarake si “grushti i shtetit”.

Një ndër mënyrat më tipike për regjimin komunist për të demonstruar fuqinë e tij, për të dëshmuar unitetin, por nga ana tjetër edhe për të ushqyer ndjenjat nacionaliste kanë qenë paradat ushtarake sidomos në festat me natyrë patriotike si 28-29 nëntori. Këto shfaqje publike kontribuonin në rritjen vetëvlerësimit kombëtar, por gjithmonë duke ja njohur këtë meritë udhëheqjes komuniste dhe lidërshiptit të saj. Mesazhet e përcjella përmes demonstrimit të trupave nuk vlerësohen ushtarakisht se kishin natyrë ofensive dhe nuk kishin target asnjë shtet tjetër, pasi politikat e sigurisë së RPSH kanë pasur gjithmonë tipar mbrojtës. Por ato ishin një produkt propagandues që rrisnin artificialisht kapacitetin ushtarak që ishte vënë i tëri jo në shërbim të kombit por të regjimit që përfaqësonte partinë e vetme në pushtet.

Besnikëria është një tjetër koncept i rëndësishëm në diskutimin mbi mesazhin nacionalist pasi i përket ndjenjës së besnikërisë së ushtarakëve ndaj qeverisë, vendit. Ashtu si kishte ndodhur me lëvizjet nacionaliste të Hitlerit apo Stalinit, të cilët kishin hapur rrugën e tyre përmes spastrimit të elitës ushtarake, të njëjtën gjë bëri edhe Enver Hoxha në mesin e viteve 70-të, kur izolimi ishte pothuajse absolut (marrëdhëniet me Kinën kishin hyrë në krizë). Lideri komunist Enver Hoxha, veçanërisht pas vitit 1974 kur u eliminua dhe i ashtuquajtur grup puçist në fjalimet e tija nuk ngurronte të pohonte se “strumbullari i punëve në ushtri ishte Partia”. [23]

Duke i mëshuar besnikërisë tek ushtria u bë tepër e dukshme lidhja gjeopolitike me territorin ku ushtronin detyrën duke mitizuar historinë, veçanërisht atë të Luftës së Dytë Botërore (si p.sh imitimi i koncepteve lufta për mëmëdheun sipas modelit sovjetik). Ishte pikërisht kjo teknika që u ndoq në formësimin e ushtrisë, amalgimi i ndjenjës nacionaliste dhe besnikërisë ndaj idesë së një force të armatosur që përgatitet të luftojë për t'u çliruar nga kontrolli i huaj, duke shmangur plotësisht vëmendjen nga kontrolli i brendshëm totalitar. Barazimi që regjimi arriti të fuste përmes propagandës nacionaliste mes besnikërisë ndaj detyrës dhe besnikërisë ndaj partisë shtet, shtrembëroi edhe misionin e ushtrisë popullore duke e kthye ashtu si edhe përmendet në dokumentet e Sigurimit të Shtetit në një armë të diktaturës së proletarietit.

Për këtë ishte e nevojshme që ushtria të shndërrohej në armatën më të madhe për të ruajtur sa më gjatë pushtetin e diktaturës së proletarietit. Ushtria ishte e bindur se mbrojtja e sovranitetit ishte e barazvlershme me sistemin izolacionist të zgjedhur nga regjimi komunist. E ushqyer me frymën e rezistencës kundër ndërhyrjeve të jashtme dhe të brendshme, duke përdorur historinë, duke e mitizuar atë me shprehje si “Populli shqiptar e ka çarë rrugën e historisë me shpatë në dorë”, [22] brenda forcave të armatosura për shkak të këtij nacionalizmi komunist u rrit fuqishëm reagimi i dhunshëm militant. Për të kuptuar sesi kishin ndikuar në jetën e përditshme të forcave të armatosura mesazhet e unitetit kombëtar, të sakrificës dhe patriotizmit, një dëshmi e qartë dhe e dhimbshme janë në ngjarjet e vitit 1990. Vrasjet në kufi dhe angazhimi i ushtarakëve për t'ju kundërvënë popullsisë civile me armë në demonstratat e para antikomuniste. E gjitha kjo ishte rezultat i patriotizmit dhe besnikërisë ndaj institucioneve dhe shtetit partiak.

### ***Përfundime***

Në përmbyllje të këtij punimi, mund të konkludojmë se regjimi komunist gjatë procesit të formimit të shtetit të ri socialist shqiptar pas vitit 1945 u angazhua në një propagandë aktive brenda radhëve të forcave të armatosura kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm. Kjo frymë si e dëshmuam edhe më lart prodhoi një ndjenjë të fuqishme nacionalizmi me tipare komuniste dhe një patriotizëm tejet të militarizuar. Politikat e mbrojtjes në RPSH në emër të përmbushjes së misionit të tyre historik si dhe identitetit kulturor u përdorën nga regjimi komunist për të legjitimuar pushtetin dhe u bënë shtrat i retorikës nacionaliste komuniste me kah nga militarizimi. Aq sa mund të thuhet se u kthyen në mite të nacionalizmit mbi fuqinë ushtarake të një shteti periferik si Shqipëria në gjeopolitikën globale.

Backgroundi dhe faktorët e brendshëm sugjerojnë si tezë kryesore studimi se në rastin e Forcave të Armatosura kemi një shfaqje të propagandës dhe agjitacionit nacionalist të nevojshëm për mobilizimin e tyre mbi rreziqet dhe kërcënimet e hamendësuar sipas një shablloni të krijuar nga regjimi komunist.[24] Sigurisht, mungesa e legjitimitetit qeverisës dhe lëvizjet e herë pas herëshme provokative nacionaliste të mbështetura në mite mund të përktheheshin në rrezikun e një konflikti, por ishin larg natyrës hegjemoniste duke dëmtuar më shumti mjedisin e brendshëm dhe kjo e bën të dallueshëm dhe unik nacionalizmin komunist shqiptar.

## Referencat

- [1]. M. Mevius, "Reappraising Communism and Nationalism," *Nationalities Papers*, vol. 37, no. 4, pp. 377–400, 2009, doi: 10.1080/00905990902985637.
- [2]. B. Posen, "'Nationalism, the Mass Army, and Military Power,'" *International Security*, vol. 18, no. 2, pp. 80–124, 1993, pp.81 Accessed: Oct. 20, 2022. [Online]. Available: [muse.jhu.edu/article/447081](http://muse.jhu.edu/article/447081).
- [3]. T. Marinov and A. Vezenkov, *Entangled Histories of the Balkans Communism and Nationalism in the Balkans: Marriage of Convenience or Mutual Attraction?.*, vol. II. Brill, 2014, pp.469. doi: 10.1163/9789004261914\_007
- [4]. D. Kaiser, "Lessons of the history of nationalism:Comments," *Springer*, vol. 23, no. 1, pp. 147–150, Feb. 1999.
- [5]. H. Adam, "Exclusive nationalism versus inclusive patriotism: state ideologies for divided societies," *Taylor & Francis*, vol. 3, no. 4, pp. 569–587, 1990.
- [6]. W. Connor, *The national question in Marxist-Leninist theory and strategy*. New Jersey: Princeton University Press, 1984.
- [7]. *Historia e Artit Ushtarak Botëror*. Tiranë: Akademia Ushtarake, 1987.fq.13,14,21
- [8]. J. Rrapaj and K. Kolasi, "The Curious Case of Albanian Nationalism: the Crooked Line from a Scattered Array of Clans to a Nation-State," *The Turkish Yearbook of International Relations*, vol. 43, pp. 185–228. Accessed: Oct. 15, 2022. [Online]. Available: <http://www.politics.ankara.edu.tr/dergi/tybook/44/5>
- [9]. E. Hoxha, *Për Ushtinë Popullore*, vol. II. Tiranë: Shtëpia Botuese "Nëntori," 1983, fq.490,
- [10]. B. Fischer, *Albanian nationalism in the twentieth century*. 1995, pp.25.
- [11]. B. Fischer and O. Schmitt, *Një histori e përmbledhur e Shqipërisë*. Prishtinë: Botimet Artini, 2022, fq.214.
- [12]. M. Glenny, *Historia e Ballkanit 1804 -2012*, Botimi i dytë. Prishtinë: Shtëpia Botuese Pema, 2019, fq.562.
- [13]. E. Zalta, U. Nodelman, C. Allen, and J. Perry, "Stanford encyclopedia of philosophy." etaphysics Research Lab, Center for the Study of Language and Information, pp. 186–198, 1995.
- [14]. G. Orwell, *Notes on nationalism*. UK: Penguin, 2019.
- [15]. E. Hoxha, Vepra 67 "Të përgatitemi nga çdo pikëpamje për mbrojtjen." Tiranë: Shtëpia Botuese "Nëntori," 1989.fq 146-152.
- [16]. S. Nathanson, "Should patriotism have a future," *Patriotism in the lives of individuals and nations*, pp. 311–326, 1997.
- [17]. R. Elsie, "'Book Review: Miranda Vickers. Albania, a Modern History,'" 1995. Accessed: Oct. 02, 2022. [Online]. Available: <<http://www.elsie.de/pdf/reviews/-R1999VickersAlbania.pdf>>
- [18]. R. Schatz, E. Staub, and H. Lavine, "On the varieties of national attachment: Blind versus constructive patriotism," *Political psychology*, vol. 20, no. 1, pp. 151–174, 1999.
- [19]. E. Smaçi, "Shqipëria në Traktatin e Varshavës," Doktoratë, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2017.
- [20]. E. Hoxha, Vepra 57, "Në ushtri të mos veprohet kurrë formalisht",. Tiranë: Shtëpia Botuese "Nëntori," 1987, fq.396.
- [21]. E. Hoxha, Vepra 68, "Të përgatitemi sa më mirë ushtarakisht",. Tiranë: Shtëpia Botuese "Nëntori," 1989. fq.5.
- [22]. "Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë." Qendra e publikimeve Zyrtare, 1976. [Online]. Available: <https://shtetiweb.org/2013/10/08/kushtetuta-e-republikes-socialiste-te-shqiperise-1976/>
- [23]. E. Hoxha, Vepra 54, "Strumbullari i punëve në Parti është ushtria." Tiranë: Shtëpia Botuese "Nëntori," 1987, fq.238.
- [24]. M. Brown, O. Cote, S. Lynn Jones, and S. Miller, *Nationalism and ethnic conflict*. MIT Press, 2001, pp.67.